

RAPORT ANALITIK I KOMISIONIT EVROPIAN PËR FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK, NË KUADËR TË OPINIONIT TË KOMISIONIT MBI APLIKIMIN E SHQIPËRISË PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EVROPIAN

KAPITULLI 5: Prokurimi Publik

Legjislacioni i Bashkimit Evropian për prokurimin publik përmban parimet e përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit. Për më tepër, rregulla të veçanta të BE-së zbatohen për dhënien e kontratave publike për punë, mallra dhe shërbime, për sektorët klasikë, për utilitetet dhe për fushat e mbrojtjes dhe sigurisë. Fusha e zbatimit përcaktohet sipas enteve kontraktuese, kontratave përkatëse, kufijve monetarë dhe përjashtimeve specifike. Legjislacioni i BE-së vendos gjithashtu rregulla mbi procedurat e rishikimit dhe mjeteve ligjore.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) përcakton se Kompanitë e Bashkimit Evropian, të vendosura apo jo në Shqipëri, duhet të kenë akses në procedurat e prokurimit në Shqipëri në bazë të një trajtimi jo më pak të favorshëm se ai ndaj kompanive shqiptare.

Legjislacioni shqiptar është përafuar gjerësisht me parimet e përgjithshme të zbatueshme për prokurimin publik në tregun e brendshëm. Megjithatë, jo të gjitha dispozitat e direktivave të prokurimit publik janë transpozuar deri tani.

Dhënia e kontratave publike rregullohet nga ligji i 2006 për prokurimin publik, i cili është amenduar së fundmi në 2009. Për zbatimin e tij ekzistojnë rregulla të detajuara. Ligji i prokurimit publik është i përafuar me parimet bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Megjithatë, përafrim i mëtejshëm kërkohet për disa procedura prokurimi, mjetet ligjore dhe prokurimin në fushën e mbrojtjes. Ligji i vitit 2006 për koncesionet siguron kuadrin ligjor për koncesionet. Rregulla të detajuara ekzistojnë për procedurat koncesionare. Ligji i koncesioneve nuk është i përafuar me legjislacionin e BE-së dhe nuk përmban dispozita në lidhje me koncesionet e punëve dhe shërbimeve. Shqipëria nuk ka legjislacion të veçantë për partneritetet private publike.

Përsa i përket kapacitetit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është autoriteti qeveritar përgjegjës për politikëbërje dhe zbatim në fushën e kontratave publike dhe koncesioneve. APP jep gjithashtu këshilla dhe mbështetje enteve prokuruese për zbatim të drejtë të legjislacionit. Agjencia e

Prokurimit Publik nuk është më përgjegjëse për procedurat e rishikimit, pasi një institucion i ri, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), u krijua për këtë qëllim me ndryshimet e fundit në ligjin e prokurimit publik. Rrjedhimisht, stafi i APP-së është reduktuar nga 36 në 18 dhe vëmendje kërkohej për të garantuar që APP të mbajë kapacitet të mjaftueshëm. Krijimi i KPP-së siguron ndarje të funksioneve të politikëbërjes dhe zbatimit nga ato të rishikimit, duke e sjellë sistemin më afër rregullave të BE-së. KPP është përgjegjës për procedurat e rishikimit, si për kontratat publike ashtu dhe koncesionet. Anëtarët e tij zgjidhen nga Këshilli i Ministrave. Momentalisht, Komisioni i Prokurimit Publik ka një staf prej 18 punonjësish. Është e nevojshme të sigurohet që KPP ka burime të mjaftueshme për të kryer me efekt funksionet e tij. Ruajtja e pavarësisë së KPP-së do të jetë thelbësore. Vëmendje të veçantë duhet të kushtohet për të shmangur konfliktin e interesave dhe parandaluar korrupsionin. Përgjegjësitë e KPP-së dhe APP-së si dhe rregullat për bashkëveprim ndërmjet tyre duhet të përcaktohen qartë.

Avokati i Prokurimit Publik filloi punën në vitin 2008 për të kryer funksione të ngjashme me një ombudsman, duke mbrojtur të drejtat dhe interesat e operatorëve ekonomikë kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve kontraktore. Avokati i Prokurimeve zgjidhet nga Parlamenti për një afat 5-vjeçar, me propozimin e Këshillit të Ministrave. Në fushën e koncesioneve, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve në Ministrinë e Ekonomisë ka disa funksione për përkrahjen dhe asistimin e autoriteteve kontraktore në vlerësimin dhe negociimin e koncesioneve.

Përfundim

Deri tani Shqipëria ka përmbushur angazhimet e saj në këtë fushë, në kuadër të MSA-së. Kuadri ligjor dhe institucional siguron një bazë të mirë për zhvillimin e një sistemi efektiv të prokurimit publik sipas rregullave të BE-së. Kapacitete të mjaftueshme nevojiten të sigurohen në të gjithë institucionet e prokurimit publik, si dhe përkufizime të qarta të përgjegjësive dhe mekanizmave të bashkëpunimit duhet të vendosen. Ruajtja e pavarësisë dhe efektshmërisë së procedurave të rishikimit do të jetë thelbësore. Shqipëria duhet të ndër marrë përpjekje të tjera për të përafuar më tej legjislacionin me atë të BE-së dhe zbatimin e tij efektiv në një periudhë afatmesme, veçanërisht në fushat e koncesioneve dhe rishikimit.